



FOTO: ETNO DHOMA LUBNICE (BERANE) – PUNËTORI ME GAZETARË

# PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT BULETINI

IPA Programeve të Bashkëpunimit  
ndërkufitar Mal i Zi - Shqipëri dhe Mal i  
Zi - Kosovë 2014- 2020

## Gusht 2022

PËRMBAJTJA

Edicioni i katërbëdhjetë i buletinit ju sjell informacione mbi aktivitetet e zbatuara në kuadër të dy programeve IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë\* 2014-2020. Programet dhe aktivitetet e projektit financohen nga Bashkimi Evropian.

Më shumë informacione për programet mund të gjeni më poshtë.

### Programi IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të promovojë dhe të forcojë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zhvillimin socioekonomik të rajoneve kufitare, përmes valorizimit të potencialeve turistike dhe një zhvillimi ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

### Programi IPA BNK Mal i Zi- Kosovë 2014-2020

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të përmirësojë standardet dhe cilësinë e jetës së njerëzve në zonën e programit nëpërmjet zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të rajonit në respekt të trashëgimisë së përbashkët kulturore dhe natyrore.

Klikoni [këtu](#) për më shumë informacione.

- »» Organizohet punëtorja ndërkufitare për gazetarët.....2
- »» Të reja nga projektet në Thirrjen e II-të të Programit IPA BNK Mal i Zi – Shqipëri.....5
- »» Të reja nga projektet në Thirrjen e II-të të Programit IPA BNK Mal i Zi – Kosovë.....8
- »» Programet e bashkëpunimit ndërkufitar u promovuan në Panairin e Projekteve Evropiane.....10
- »» Sekretari i shtetit Mashkoviq takohet me Ministrin Krasniqi në Mal të Zi.....11

Ky publikim është prodhim i mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve IPA BNK Mali i Zi – Shqipëri dhe Mali i Zi – Kosovë 2014-2020 dhe nuk paraqet domodoshmerisht mendimet e Bashkimit Evropian.

Bashkimi Evropian

European Union

\*Ky shënim është pa paragjykim të pozicioneve për status dhe është në linjë me RKS KB 1244 dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.



Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian



MNE - ALB

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI – SHQIPËRI 2014-2020



MNE - KOS

IPA PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI – KOSOVË 2014-2020

## CBC ZOOM

### Organizohet punëtorja ndërkufitare për gazetarët


Sekretariati i Përbashkët Teknik (SPT) organizoi dy punëtori për gazetarë në kuadër të programit Mal i Zi-Shqipëri dhe Mal i Zi-Kosovë, me mbështetjen e strukturave operative të programeve, Ministrisë së Çështjeve Evropiane të Malit të Zi, Ministrisë e Financës të Malit të Zi, Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Andimistrimit të Pushtetit Lokal të republikës së Kosovës.

Punëtorja për programin Mal i Zi-Shqipëri u realizua me datë 24 qershor të vitit 2022 dhe u përfshinë vizita tek projektet që janë zbatuar apo po zbatohen në territoret e komunave Berane dhe Petnicë. Gazetarët u shoqëruan në këtë punëtori nga drejtuesja e SPT-së **Sanja Todoroviç**, dhe **Nikolla Gjonoviç**, zyrtarë projekti pranë SPT-së. Me qëllim promovimin e rezultateve të projekteve të financuara nga programi IPA BNK Mal i Zi-Shqipëri, punëtorja u organizua si një udhëtim i gazetarëve nga Mali i Zi, duke i mundësuar atyre të vizitonin projektet dhe arritjet e tyre në terren dhe të diskutonin me aktorët kryesorë dhe përfituesit final, mbi rëndësinë e këtyre projekteve, bashkëpunimit ndërkufitar dhe përfitimet nga mbështetja e BE-së për komunitetet lokale.



Tokom radionice, novinari su imali priliku da posjete lokacije koje su Gjatë punëtorisë, gazetarët patën rastin të vizitojnë disa nga rezultatet e arritura nga projektet e kontraktuara nga Thirrja e parë dhe e dytë në kuadër të programit IPA BNK Mal i Zi-Shqipëri. Ato vizituan projektet Rritja e bashkëpunimit – Nga antikitetet Kristiane drejt përmirësimit të Turizmit; Ruajtja e peisazheve kulturore në Shqipëri dhe Mal të Zi; Kuzhina lokale si ofertë turistike e rajonit ndërkufitarë dhe Të Rinjtë Malazez dhe Shqiptarë për kulturën e Lule Mjadrës.

Në muzeun Polimje, gazetarët vizituan ekspozitën e artefakteve nga siti arkeologjik i Donja Rzhanica. Artefaktet që tashmë janë bërë pjesë e ekspozimit të vazhdueshëm të muzeut, janë zbuluar gjatë aktivitetit të gërmimeve si pjesë e projektit Rritja e bashkëpunimit – Nga antikitetet



Kristiane drejt përmirësimit të Turizmit. Gjithashtu, gazetarët intervistuan dhe diskutuan arritjet e projektit me drejtuesen e muzeut, **Violeta Foliq**, arkeologun dhe kuratorin e muzeut **Predrag Lutovac** dhe kryetarin e komunes së Beranes, **Vuko Todoroviç**.



Përfundimet e bashkëpunimit ishin që, fondet e BE-së për programet BNK kontribuojnë për zhvillimin e sektorit të turizmit në komunën e Beranes dhe në valorizimin e trashigimisë kulturore të rajonit. Pas kësaj, të gjithë pjesëmarrësit vizituan sitin arkeologjik Tumbarice në Donja Rzhanica dhe mbetjet e zbuluara nga gërmimet në Qytetin Tumba.



Në vijim të vizitës në Tumbericë, gazetarët vizituan Etno Dhomën e rinovuar si pjesë e projektit *Ruajtja e peisazheve kulturore në Shqipëri dhe Mal të Zi* dhe intervistuan përfaqësuesen e Agjencisë për Zhvillim Rajonal për Bjelasica, Komovi dhe Prokletitje, **Radojka Shqekiq** me të cilën diskutuan për trashigiminë kulturore të zonës dhe vlerat e shtuara që sjell ky projekt për turizmin malor.



Gjithashtu, u theksua mbështetja për familjet rurale dhe përpjekejt e tyre për të qëndruar në zonat e veriut të Malit të Zi. Pas një pushimi të shkurtër, udhëtimi vazhdoi drejt shtëpisë së familjes **Kljajiq**, përfitues të projektit *Kuzhina lokale si ofertë turistike e rajonit ndërkufitarë*. Në shtëpinë e tyre, gazetarë folën me pjesëtarët e familjes mbi sfidat dhe përfitimet e turizmit rural dhe rolit të rëndësishëm që luan tek familjet që jetojnë në këto zona.



Në përfundim, gazetarët u pritën nga **Ziko Aliloviq**, sekretari I komunës së Petnicës. Me gazetarët u diskutua mbi rëndësinë e fondeve të BE-së për sektorin e punësimit në këtë komun dhe ndikimin që projektet kanë tek përfituesit pasi 20 plantacione të reja me lule mjedër u krijuan si pjesë e projektit *Të Rinjtë Malazez dhe Shqiptarë për kulturën e Lule Mjedrës*.



Pas intervistës, pjesëmarrësit vizituan plantacionet me lule mjedër të familjes **Agoviq**, një nga përfituesit final të projektit, dhe biseduan për përfitimet që ka popullsia lokale nga rritja e lule mjedrës dhe mundësitë e përmirësimit të vendosjes në treg të produktit.

Si pjesë e aktiviteteve të Ipa Programit Mal i Zi- Kosovë, me datë 1 korrik të vitit 2022 është organizuar një punëtori e cila përfshinte vizitë studimore tek projektet që janë zbatuar/zbatohen në komunat e Gucisë, Plavës dhe Andrijevicës. Gazetarët gjatë eventimit promovues ishin të shoqëruar nga Shefja e Sekretariatit të përbashkët Teknik, **Sanja Todoroviq**, Zyrtari i projekteve nga Sekretarijati i Përbashkët Teknik, **Allmir Çausheviq**, si dhe nga përfaqësuesit i Ministrisë për Çështje Evropiane të Malit të Zi, **Stefan Bulatoviq**.



Gjatë punëtorisë, gazetarët paten mundësinë të vizitojnë rezultatet e arritura në kuadër të projekteve të kontraktuara nga Thirrja e parë dhe Thirrja e dytë të Ipa Programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi-Kosovë; më saktësisht vizituan projektet „*Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike*“, „*Bjeshkët e Nemuna – destinacion natyror tërheqës*“, „*Iniciativa të përbashkëta ndërkufitare për menaxhim më të mirë të mbeturinave*“, „*Qendrat turistike për oferta më të mira turistike në zonat malore më pak të zhvilluara*“, „*Katunet – oferta e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi*“ dhe „*Trashëgimia kulturore – Thesar i rajonit ndërkufitar*“.



Gjatë qëndrimit në Guci, gazetarët paten mundësinë të vizitojnë Info Qendren turistike, e cila është ndërtuar dhe pajisur në kuadër të projektit „*Trashëgimia kulturore – Thesar i rajonit ndërkufitar*“, si dhe të informohen detajisht nga përfituesit e projektit mbi aktivitetet që janë zbatuar dhe mbi aktivitetet që janë planifikuar të zbatohen në kuadër të projektit. Po ashtu, gazetarët vizituan edhe Organizatën turistike të Gucisë ku janë kishin mundësi të informohen mbi projektet, si edhe të shohin paisjet e prokurara dhe materialet promovuese të prodhuara në kuadër të projekteve „*Zhvillimi i eko-turizmit në Alpet Ballkanike*“ dhe „*Bjeshkët e Nemuna – destinacion natyror tërheqës*“.



Gjithashtu, gazetarët biseduan edhe me kryetaren e Komunës së Gucisë, znj. **Anela Çekiq**, dhe zyrtarët tjerë administrates së pushtetit lokal mbi temën se çfarë kontribuan bashkëpunimi ndërkufitarë dhe fondet e BE-së në zhvillimin e sektorit të turizmit në Guci dhe u informuan mbi oferten e re turistike "Si të kaloni 1, 4, apo 7 ditë në Bjeshkët e Nemuna". Pas një pushimi të shkurtë, udhëtimi vazhdojë kah komuna e Plavës ku ato vizituan oborrin e riciklimit I cili është ngritur në kuadër të projektit "Iniciativa të përbashkëta ndërkufitare për menaxhim më të mirë të mbeturinave".



Gazetarët diskutuan me drejtorin e Ndërmarrjes Publike të Plavës, **Ervin Toshiq**, mbi procesin e riciklimit që u krijua për herë të parë në veri të Malit të Zi, menaxhimin e oborrit të riciklimit dhe tema të tjera të ngjashme. Gazetarët shfrytëzuan rastin për të marrë informacion mbi sasinë e mbetjeve që riciklohen, mënyrat e grumbullimit dhe mënyrën e përdorimit të mbetjeve për qëllime shitjeje.



Pas Komunes së Plavës, vazhduan kah komuna e Andrijeviçes ku autoritetet lokale pritën gazetarët. Gazetarët patën mundësinë të diskutojnë mbi ndikimin e projektit „Qendrat turistike për oferta më të mira turistike në zonat malore më pak të zhvilluara” me nënkryetarin e

komunës së Andrijeviçes **Vesko Raketiq**, menaxherin e projektit **Miodrag Ivanoviq**, si dhe me perfaqësuesit tjerë të pushtetit lokal.



Pas përfundimit të takimit në ndërtesën e komunës, gazetarët udhëtuan për në Krivi do (zona malore mbi Andrijeviçë) dhe vizituan shtëpizën e Turizmit/Bjeshkatarëve e cila ishte adaptuar në kuadër të projektit të lartpërmendur. Në vendin e ngjarjes në Krivi do, gazetarët janë informuar nga menaxheri i projektit **Miodrag Ivanoviq** për planin e menaxhimit të shtëpizës, mbi shtigjet të përbashkëta që do të vendosen për të lidhur shtëpizën turistike në Krivi Do me shtëpinë e bjeshkatarëve që është duke u ndërtuar në Bjeshkët e Belegut në Kosovë, si dhe mbi kapacitetet dhe shërbimet që do të ofrohen në këto objekte.



Në fund, gazetarët u pritën nga **familja Asanoviq** e cila është pronare dhe nikoqire në katunin Bačko Brdo dhe një nga amvisëritë që ishin përfutuesit përfundimtarë të projektit „Katunet – oferta e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi”. Në vendin e ngjarjes në Bačko Brdo, **Dalibor Shekularac** nga Agjencia për Zhvillim Rajonal për Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije, si përfutues i projektit, dha informacion mbi zonën dhe rezultatet që janë arritur brenda projektit. Gjatë drekës tradicionale që u organizua nga familja Asanoviq, gazetarët patën mundësinë të diskutojnë dhe të marrin më shumë informacion mbi ndikim e projektit nga përfutuesit e tij përfundimtar.



## Te reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Shqipëri

### Punëtori me të rinjtë mbi bimët medicinale dhe aromatike

Si pjesë e projektit *Promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të bimëve aromatike dhe medicinale për përmirësimin e jetesës dhe ruajtjen e biodiversitetit* u organizuan 3 punëtori me nxënësit nga shkollat e mesme dhe studentët e Plavës. Ky projekt zbatohet nga komuna e Plavës në bashkëpunim me bashkinë Tropojë, si dhe me OJF DIDCK dhe OJF Alpet Shqiptare.



Trajnime të avancuara dhe punëtori bazike, mbi bimët medicinale dhe aromatike, me studentët dhe nxënësit e shkollave të mesme, u mbajtën në Plavë, gjatë muajit qershor të vitit 2022. Qëllimi i trajnimeve të organizuara në shkollën e mesme "Beqo Bashiq" ishte rritja e ndërgjegjësimit tek të rinjtë mbi bimët medicinale dhe aromatike. Pjesëmarrësit treguan interes për të mësuar më shumë mbi bimët medicinale dhe aromatike që rriten në zonën e tyre.



Të rinjtë nga zona e Plavës u trajnuan për llojet e bimëve medicinale dhe aromatike që rriten në këtë zonë si dhe mbi mënyrën e duhur të mbledhjes së tyre.



Ky projekt synon të përmirësojë mbrotjen e biodiversitetit dhe bimët e rrezikuara medicinale dhe aromatike të zonës, nëpërmjet përmirësimit të njohurive, praktikave të mbledhjes dhe procesimit të bimëve dhe të kontribuojë në përdorimin e qëndrueshëm të bimëve medicinale dhe aromatike për ekonominë lokale të zonës së projektit.

### U organizuan trajnime dhe stërvitje për mbrotje dhe shpëtim në raste zjarresh

Me mbështetjen e Bashkimit Europian të projektit "Fatkeqësitë natyrore nuk njohin kufinj 2", u organizua në Podgoricë me datën 3 qershor të vitit 2022 një stërvitje demonstrative mbi mbrotjen nga zjarret dhe shpëtimin, gjatë të cilës 35 anëtar të shërbimit të shpëtimit nga Mali i Zi dhe Shqipëria treguan gatishmërinë e tyre për reagim në përgjigje të këtyre rasteve.



Stërvitja u organizua në vijim të trajnimit të mbajtur 4-ditorë për anëtarët e shërbimit të shpëtimit nga dy vendet, në të cilat u përfshinë pjesë teorike dhe praktike, dhe u mësuan metodat moderne për mbrotjen dhe shpëtimin në rast zjarresh. Trajnerët ishin oficerë dhe instruktorë të brigadës së zjarrfikësve nga të Qarkut Primorje-Gorski Kotar me eksperiencë të gjatë në këtë fushë nga Kroacia - **Nikola Tramontana, Dario Gaush, Sinisha Kauzlaric dhe Igor Hrela.**



### Aktivitetet e projektit SOLUTION

kampionimit të ujit dhe sedimentit në pjesën shqiptare të Liqenit të Shkodrës, nga partneri i projektit, Universiteti i Tiranës.

Gjithashtu, nga data 27 qershor deri me 1 korrik të vitit 2022, një trajnim u organizua tek Qendra e Hulumtimeve Eko-Toksikologjike të Podgoricës për stafin e Universitetit të Tiranës, Fakultetit i Shkencave Natyrore, në lidhje me analizimin dhe përcaktimin e koncentrimit të metaleve në ujë dhe sedimenteve, me teknikat më të reja. Për më tepër, stafi i Universitetit të Tiranës, u trajnuan për përcaktimin e ushqyesve në ujë siç janë fosfori dhe fosfatet.

Me datë 8 korrik, u mbajt në Shkodër, tryeza e parë e rrumbullakët ku u mbledhën pjesëmarrës nga institucionet lokale dhe rajonale të mjedisit dhe shëndetësisë, institucionet e kërkimit dhe shkencës, bashkia Shkodër, Prefektura dhe OJF-të lokale.



Pas prezantimit të aktiviteteve dhe rezultateve të para të projektit, u mbajt një diskutim mbi temën "Ndotja e Liqenit të Shkodrës, përmirësimi i balancës ekologjike dhe kërkimi shkencor në mjedis".



Projekti "Liqeni i Shkodrës pa ndotje kimike – SOLUTION" zbatohet nga Qendra për hulumtime eko-toksikologjike e Malit të Zi, Universiteti i Tiranës dhe Asocioni Green Centre nga Shqipëria

### *Forumi ndërkufitar për bashkpunimin në të ardhmen*

Me datë 6 Korrik të vitit 2022, u mbajt Forumi ndërkufitar për bashkpunimin në të ardhmen, si pjesë e projektit "Punë për të Rinjtë". Të rinjtë nga Shqipëria dhe Mali i Zi, patën rastin të komunikojnë, diskutojnë dhe shkëmbejnë eksperiencën, si dhe të marrin rekomandime nga ekspertë për zhvillimin e mëtejshëm të ideve të tyre të biznesit.



Forumi u mbyll me këshilla praktike dhe informacione për mjetet që mund të përdoren kur diskutohet me investitorët.

Si pjesë e aktiviteteve promovuese, projekti vazhdon të promovojë idetë e sipërmarrjes nga të rinjtë. Shikoni [ketu](#) disa nga idetë e sipërmarrjes të mbështetura nga projekti. Projekti "Punë për të Rinjtë" zbatohet nga Partnerët Shqipëtarë për Zhvillim dhe Ndryshim, Asocioni për Demokraci dhe Prosperitet – Zid dhe Intelektualët e Rinj – Shpresë.

### *Aktivite promovionale në Shqipëri dhe Mal të Zi*

Si pjesë e aktiviteteve të projektit "Mali i Zi dhe Shqipëria drejt zero mbetjeve" gjatë muajit qershor u organizua një fushatë pastrimi në Margegaj. Ky aktivitet ishte pjesë e fushatës që shënoi hapjen e sezonit turistik në Valbonë.





Në Mal të Zi, gjatë muajit korrik, 150 shtëpi pritëse dhe restorante nga Gucia, morën kompostues mbetjesh. Më saktë, kompostuesit ju dhanë banorëve në Vishnjevo, Krushevo, Kolenoviq, Vuthaj, Martinoviq dhe Dosugje. Kjo u bë si pjesë e fushatës “derë më derë” mbi kompostimin dhe parandalimin e mbetjeve organike.



### *Panairi për punësimin e personave me aftësi të kufizuara nga projekti A.C.C.E.N.T.*

Si pjesë e projektit A.C.C.E.N.T. një panair për punësimin e personave me aftësi të kufizuara (PAK) u organizua me datë 28 korrik në Tivar. Qëllimi i eventit ishte të mblidhte të gjithë aktorët e rëndësishëm nga sektori publik, privat dhe civil me personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që t'i jepte atyre informacionet mbi mundësitë e punësimit, trajnimit dhe edukimit.



Panairi u hap nga kryepeshkopi i Tivarit, **Rok Gjonlleshaj**, presidenti i Caritas në kryepeshkopatën e Tivarit. Sipas koordinatorit të projektit **Marko Gjeloviq**, përmes këtij panairi u promovuan të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për punësim, dhe qëllimi ishte të ndërgjegjsohej publiku për mundësitë e punësimit dhe modelet e punës dhe integritimit social të tyre. “Panairi promovon shembujt dhe praktikave të mira të punësimit të PAK. Përmes prezantimit të shembujve dhe praktikave të mira, projekti synon të kontribuojë në krijimin e një modeli të qëndrueshëm punësimi për PAK dhe arritjen e standardeve të BE-së në këtë fushë. Panairi kombinoi aspekte informative, ekspozuese dhe edukative”, shpjegoi koordinatori në fjalën hyrëse të panairit.



Pjesëmarrësit u përshëndetën edhe nga **Julija Bici**, përfaqësuese e Caritas Shqipëri, partner në këtë projekt. Panairi bëri bashkë, përveç ekspozuesve dhe vizitorëve, edhe përfaqësues nga institucionet që merren me çështjen e PAK dhe përmirësimin e pozitës të tyre. Drejtuesja e Delegacionit, Ambasadoresha **Oana Kristina Popa**, përshëndeti të pranishmit dhe vlerësoi aktivitetet dhe projektet që merren me grupet vulnerabël. “Unë shpresoj që, panairi që po hap sot, në Tivar, do ofroj shanse, punë dhe të përmirësoj jetën e anëtarëve të disa prej grupeve më vulnerabël”, shtoi në fjalën e saj ambasadorja.



Panairi u ndjek edhe nga Sekretari i Ministrisë për punë dhe Mirëqënie Sociale, **Edina Deshiq**, si dhe kryetari I komunes së Tivarit, Dushan Raiçeviq, drejtuesja e Zyrës Rajonale të Punësimit Shkodër, **Rozafa Zmijani**, dhe drejtuesi i Shërbimit Social në bashkinë Shkodër, **Filip Vila**. Pas flajëve hyrëse, pjesëmarrësit në event dhe qytetarët, vizituan stendat e panairit dhe mësuam më shumë mbi mundësitë e punësimit, edukimit dhe trajnimit të grupeve vulnerabël.

Projekti “A.C.C.E.N.T. - Aksesi, Ndërgjegjja Qytetare, Punësimi i personave me aftësi të kufizuara, si një Trend i ri” zbatohet nga Caritas i

Kryepeshkopatës së Tivarit (Mal i Zi), Caritas Shqipëri, OJF Projekti Shpresë (Shqipëri) dhe Asociacion i Paraplegjikëve Tivar.

## Shkëmbimi i studentëve nga Mali i Zi dhe Shqipëria

Si pjesë e aktiviteteve të projektit "Rrugët drejt zhvillimit të karrierës (RZK): Përgatitja e të rinjve Shqiptarë dhe Malazez për mundësitë e karrierës në sektorin e turizmit" një grup studentësh nga shkolla e mesme profesionale "Hamdi Bushati" bashkë me mësuesit e tyre, vizituan shkollën e mesme "Vllazërim Bashkim" në Ulqin, për të shkëmbyer eksperinca në lidhje me të rinjtë dhe sektorin e biznesit.



Gjatë vizitës, studentët nga të dy shkollat prezantuan projektet fituese dhe diskutuan sfidat dhe pengesat për hapjen e bizneseve të vogla nga të rinjtë, ndanë eksperiencat pozitive për përfshirjen e tyre në projekt, praktikatat e mësimit, kurset profesionale, etj. Mësuesit nga të dy shkollat, shkëmbyen praktikatat e mira që kanë krijuar në lidhje me sektorin e biznesit, për krijimin e platformave të mësimit, etj.



Për më shumë, si pjesë e aktiviteteve promovuese, "Plani lokal i punësimit të të rinjve" u prezantua me datë 30 qershor zyrtarëve të komunës së Ulqinit, institucioneve publike dhe aktorëve të interesuar. Shikoni raportet e TV lokale [këtu](#).

## Të reja nga projektet e financuara në thirrjen e II-rë të programit IPA BNK Mal i Zi - Kosovë

### Fermerët nga Mali i Zi vizitojnë Kosovën

Nga data 22-24 Qershor 2022 është realizuar vizita treditore e grupit të fermerëve nga Mali i Zi me qëllim të marrjes së përvojave në sektorin e bimëve mjekësore aromatike në Kosovë, si dhe njohja me disa nga



përfituesit e granteve për kultivim të bimëve mjekësore aromatike përmes projektit "Krijimi i vendeve të punës në bujqësi".

Vizitat janë realizuar në zonën ku është duke u zbatuar projekti përkatësisht në komunën e Pejës dhe Istogut, ku janë vizituar kompanitë që merren me kultivim, grumbullim, përpunim dhe eksportim të bimëve mjekësore aromatike si janë: "AgroProduct" Shpk, "Organic Herb" Shpk, "Erblin Beqiraj" B.I., pastaj kompania kultivuese dhe eksportuese e boronicave "Boost Berries", si dhe kultivuesi dhe grumbulluesi i mjedrave Nehat Bajraktari.



Në kompanitë e latcekura grupi i fermerëve nga Mali i Zi, janë informuar me historikun e fillimit të punës së këtyre kompanive, dhe zhvillimin e tyre nga viti në vit, pastaj me aktivitetet të cilat zhvillohen në sektorin e BMA-ve dhe frutave të imëta, kapacitetet grumbulluese, kultivuese dhe shkallën e përpunimit deri në përgatitjen e produkteve për eksport në tregun evropian. Në këto kompani ata njëlkohësisht u njohën edhe me disa student/e, që kishin kryer punën praktike përmes projektit dhe tani janë punonjës/e të rregullt të kompanive.

### Katunet - oferta e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi

Me qëllim promovimin e ofertës së re turistike në zonen ndërkufitare, vazhdojnë aktivitetet promovuese në kuadër të projektit. Në Kosovë, viteve të fundit është duke lulëzuar turizmi malorë. Falë aktiviteteve të projektit, fermerët malor dhe stanet e tyre tani kanë kapacitete dhe mirëpresin turistët, të cilët më pas mund të ndërmarrin shumë aktivitete që janë tërheqëse edhe për të varurit nga adrenalina. Për më shumë detaje shikoni broshurën [këtu](#).






Projekti „Transhumance“ zbatohet nga Inicijative për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës në partneritet me Agjencinë për Zhvillim Rajonal për Bjelasicë, Komovi dhe Prokletije.

## Activitetet në kuadër të projektit PRAXIS

Gjatë kësaj periudhe, stafi i projektit PRAXIS ka hartuar publikimin *Punësimi i të rinjve dhe sipërmarrja*. Publikimi ofron informacion kyç në lidhje me mjedisin për sipërmarrjen rinore, sfidat e politikave për punësimin e të rinjve, udhëzimet për karrierë, etj. Shikoni publikimin [këtu](#).



Për më tepër, me 20 qeshor të vitit 2022, stafi i projektit ka organizuar *Job Discovery* vizita për 14 studentë nga Univerziteti "Fehmi Agani" nga Gjakova, të cilët vizituar kompanitë në Klinë (Kosovë). Studentët vizitua dy kompani të njohura companies "Ginza" Sh.P.K. dhe "8 brothers" që merren me prodhimin dhe përpunimin e dyerve dhe dritareve. Vizita ishte një mundësi e mirë për të parë pajisjet, objektet, për të marrë informacion për kushtet e punës, por edhe një mundësi për punëdhënësit që të japin informacion të drejtpërdrejtë për kompanitë e tyre, produktet, shërbimet dhe aftësitë që ata kërkojnë për punonjësit e tyre.



Projekti PRAXIS ybatohet na Caritas Kosova, Caritas Mal i Zi, QAKP Gjon Nikollë Kazazi – Gjakovë dhe komuna e Beranes. Projekti synon të mbështesë nxënësit, studentët dhe të rinjtë e papunësuar përmes sesioneve të orientimit dhe këshillimit në karrierë.

## Investimet për turizem më cilësorë në Mal të Zi dhe Kosovë

Komuna e Andrijevicës, në bashkëpunim me komunën e Deçanit dhe Shoqatën e Bjeshkatarëve „Shkelzen Haradinaj“ nga Kosova, zbatojnë projektin „Qendrat turistike për oferta më të mira turistike në zonat malore më pak të zhvilluara“. Projekti është i fokusuar në zhvillimin e turizmit rural dhe do të rezultojë në ngritjen e dy qendrave turistike në të dy vendet së bashku me ngritjen e itinerarëve nepër katune që do të angazhojnë familjet në ofrimin e shërbimeve turistike.



Aktualisht partnerët e projektit janë duke punuar në mënyrë aktive në adaptimin dhe ndërtimin e shtëpive malore në Krivi do (në Mal të Zi) dhe Bjeshkët e Belegut (në Kosovë).



Punimet në Mal të Zi kanë përfunduar dhe shtëpiza është e pajisur dhe plotësisht funksionale. Në Kosovë, punimet ndërtimore janë ende duke vazhduar dhe pritet të përfundojnë deri në nëntor të vitit 2022. Partnerët kanë iniciuar fazën e sinjalizimit të shtigjeve dhe vendosjen e itinerarëve tematike.



## Trashëgimia kulturore - Thesar i rajonit ndërkufitar

Një seri e aktiviteteve është zbatuar në kuadër të projektit „Trashëgimia kulturore – Thesar i rajonit ndërkufitar“, i cili zbatohet nga dy komunat e binjakëzuara, komuna e Pejës dhe komuna e Gucisë. Qëllimi i projektit është të kontribuojë në vlerësimin e trashëgimisë kulturore të rajonit të Bjeshëve të Nemuna duke krijuar rrugë dhe shtigje të reja kulturore si një produkt dhe ofertë të re turistike në zonën e synuar.



Më 17 maj të vitit 2022 në Guci u mbajt një trajnim i përbashkët për përfaqësuesit e komunave dhe organizatave turistike. Përkatësisht, u prezantuan ofertat turistike të Pejës dhe Gucisë dhe pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë se si të përmirësohen kushtet turistike bazuar në përvojat e tyre të deritanishme.



Gjithashtu, gjatë muajit maj të vitit 2022 u organizua një Koloni Arti në Kosovë ku artistë të ndryshëm morën pjesë në krijimin e veprave artistike që lidhen me trashëgiminë kulturore të Pejës. Pas kolonisë së mbajtur, pikturat e 10 aseteve të trashëgimisë kulturore të krijuara gjatë Kolonisë së Arteve në Kosovë u ekspozuan gjatë korrikut në ambientet e Galerisë së Arteve (Shtëpia e Kulturës) në Pejë.



Në Guci gjatë muajit gusht të vitit 2022 janë instaluar 10 pika vrojtuese në lokacione atraktive turistike që janë të lidhura me trashëgiminë kulturore të këtij rajoni.



Më në fund, ka filluar procesi i shpërndarjes së materialeve promovuese lidhur me vendet e trashëgimisë kulturore përgjatë shtegut kulturore dhe palëve të interesuara të projektit dhe ky aktivitet do të vazhdojë edhe më tej.

Ndiqui aktivitetet e projektit në [Facebook faqen](#) të dedikuar për këtë projekt.

## Programet e bashkëpunimit ndërkufitar u promovuan në Panairin e Projekteve Evropiane

Dhoma Ekonomike e Malit të Zi, në bashkëpunim me Ministrinë e Çështjeve Evropiane, organizoi Panairin e Projekteve Evropiane më 28 maj të vitit 2022 në oborrin e Kështjelles Petroviq në Podgoricë. Ngjarja që u mbajt në kuadër të festës së shënimit të Muajit të Evropës, ishte një mundësi për vizitorët që të informohen mbi projektet e realizuara nga institucionet, komunat, kompanitë, universitetet dhe sektori i OJQ-ve. Për më tepër, ngjarja ishte një mundësi aplikuesit potencial që të diskutojnë mbi aktivitetet e ardhshme dhe thirrjet e ardhshme për dorëzimin e projekt-propozime.



Manifestimin e hapën kryetarja e Dhomes Ekonomike të Malit të Zi, **Nina Drakiq**, nënkryetarja e Qeverisë së Malit të Zi dhe Ministresha e Ministrisë së Çështjeve Evropiane, **Jovana Marović** dhe ambasadorja e BE-së në Mal të Zi, **Oana Kristina Popa**. "Duke parë këto stenda, jam e bindur se i kemi përmirësuar ndjeshëm kapacitetet për shfrytëzimin e mbështetjes evropiane, por duhet ende të punojmë për t'i përforcuar ato. Ky panair ndihmon dukshëm dukshmërinë e projekteve të BE-së tek

qytetarët tanë. Ky është thelbi i procesit të integrimit evropian, që qytetarët tanë të kenë përfitime konkrete. Kjo është arritur përmes projekteve të shumta që kanë forcuar sundimin e ligjit, mbrojtjen e mjedisit, arsimin dhe kujdesin shëndetësor. Ne do të vazhdojmë të punojmë në përf forcimin e kapaciteteve të të gjitha institucioneve dhe shfrytëzuesve të programeve të BE-së me qëllim t'i zbatojmë ato në mënyrë sa më efikase”, tha nënkryetaria dhe ministresha **Maroviq**.



Në një stendë u promovuan të arriturat e programeve Mal i Zi-Shqipëri dhe Mal i Zi-Kosovë, kurse qytetarët u informuan më detalisht nga përfaqësuesit e Ministrisë së Çështjeve Evropiane dhe Sekretariatit të Përbashkët Teknik të Programeve të bashkëpunimit ndërkufitar Mal i Zi - Shqipëri dhe Mal i Zi - Kosovë.



### Sekretari i shetit Mashkoviq takohet me Ministrin Krasniqi ne Mal të Zi


Më 20 korrik të vitit 2022, Sekretari i shtetit dhe Koordinatori Nacional i IPA-së në Ministrinë e Çështjeve Evropiane të Malit të Zi, **Aleksandar Mashkoviq**, është takuar me Ministrin e Ministrisë së Administrimit të pushteit lokal të Republikës së Kosovës, **Elbert Krasniqi**.



Takimi u organizua me qëllim të diskutimit të zbatimit aktual të programit dhe aktiviteteve të projekteve në kuadër të IPA Programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mal i Zi – Kosovë. Pas bisedës së tyre u konstatua se Mali i Zi dhe Kosova do të vazhdojnë të bashkëpunojnë përmes Programit të ardhshëm IPA III, ku do të jenë në dispozicion 8.4 milionë euro për projekte në fushën e inkurajimit të punësimit të grupeve vulnerabël dhe turizmit të qëndrueshëm.



Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushteit Lokal Elbert Krasniqi gjatë qëndrimit në Mal të Zi ka vizituar edhe zonen e programit dhe projektet e financuara në kuadër të IPA Programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mal i Zi – Kosovë. Nga vizitat e organizuara u konstatua se projektet e realizuara ndërmjet komunave Andrijević - Deçan, Pejë - Guci dhe Plavë - Gjakovë, forcojnë bashkëpunimin ndërkufitar dhe ndërinstitucional dhe hapin perspektiva për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.



» Strukturat Operuese të programit (klikoni tek ikona për të shkruar tek web - faqja)



Montenegro  
Ministry of European Affairs



Montenegro  
Ministry of Finance  
Directorate for Finance and Contracting  
of the EU Assistance Funds



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
KRYEMINISTRIA  
AGJENCIA SHITËTËRORE E PROGRAMIT STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Pushtetit Lokal  
Ministarstvo lokalne samouprave  
Ministry of Local Government



**SEKRETARIATI I PËRBASHKËT TEKNIK I IPA  
PROGRAMEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR  
MALI I ZI - SHQIPËRI DHE MALI I ZI - KOSOVË 2014-2020**

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra kryesore**  
Adresa: Beogradska 17, 81 000 Podgorica, Mal i Zi  
Telefon: + 382 20 240 784; + 382 20 240 631;

**Sanja TODOROVIC**

Drejtuuese e Sekretariatit të Përbashkët Teknik  
E-mail: [sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:sanja.todorovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Maja RADOVIC**

Zyrtare për Prokurimet dhe Financat  
E-mail: [maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:maja.radovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Nikola DJONOVIC**

Zyrtar Projekti  
E-mail: [nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:nikola.djonovic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Almir CAUSEVIC**

Zyrtar Projekti  
E-mail: [almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:almir.causevic@jts-mne-alb-mne-kos.org)

**Petar BELADA**

Asistent Administrativ  
E-mail: [petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:petar.belada@jts-mne-alb-mne-kos.org)

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Shkodër**  
Adresa: Rruga Ndoc Çoba, Nr 1 Shkodër, Shqipëri  
Telefon: + 355 22 80 20 80;

**Andi ÇEKAJ**

Zyrtar Projekti, Antenë  
E-mail: [andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:andi.cekaj@jts-mne-alb-mne-kos.org)

Sekretariati i Përbashkët Teknik – **Zyra Antenë Prishtinë**  
Adresa: Kompleksi PRIME, rruga "Tirana", Hyrja D, kati 5, Zyra nr. 53, Prishtinë,  
Kosovë

**Gazmir RACI**

Zyrtar Projekti, Antenë  
E-mail: [gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org](mailto:gazmir.raci@jts-mne-alb-mne-kos.org)

[www.cbc-mne-alb.org](http://www.cbc-mne-alb.org) | [www.cbc-mne-kos.org](http://www.cbc-mne-kos.org)



@cbc.mne.alb



@cbc.mne.kos



Ky projekt është i financuar  
nga Bashkimi Evropian